



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA008

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagendra

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41 (10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 58, 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelin e z. Kadri Veseli të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të tij.¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, z. Veseli u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 tetor 2020² dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë në të njëjtën ditë.³
2. Më 2 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kontestuar në të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli.⁴
3. Më 15 korrik 2021, z. Veseli parashtrroi Apelin.⁵

II. KLASIFIKIMI

4. Apeli është i klasifikuar si konfidencial dhe rrjedhimisht ky vendimi do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të

¹ IA008/F00001, Apel i Mbrojtjes së Veselit i Vendimit KSC-BC-2020-06/F00380 (Rishikimi i Parë i Paraburgimit), 15 korrik 2021 (konfidencial) (“Apeli”). Shih edhe F00380/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit, 2 korrik 2021 (“Vendimi i Kontestuar”).

² Shih F00027, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 26 tetor 2020 (“Vendimi mbi Fletarrestimet”).

³ Shih F00054, Njoftim i Pranimit të Kadri Veselit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 5 nëntor 2020.

⁴ Shih Vendimin e Kontestuar, para. 57(a).

⁵ Shih në përgjithësi Apelin.

riklasifikohet në kohën e duhur.

III. CAKTIMI

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për Apelin.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 19 korrik 2021
Në Hagë,
Holandë.